

LLOJET E DHUNËS

Abuzimi emocional – shkatërrimi i ndjenjës së vetëvlerësimit dhe/ose të vetëbesimit të një individi. Kjo mund të përfshijë kritikën e vazhdueshme, poshtërimin, përçmimin e aftësive të një personi, sharjet, degradimin dhe dëmtimin e marrëdhënieve të dikujt me fëmijët e tij ose të saj.

Abuzimi psikologjik – përfshin shkaktimin e frikës nëpërmjet trembjes; kërcënimin për dëmtim fizik të vetes, partnerit, fëmijëve ose të familjes së partnerit apo të miqve; kërcënimin për braktisje; vrasjen e kafshëve shtëpiake dhe shkatërrimin e pronës; kërcënimet për marrjen e kujdestarisë së fëmijëve; izolimin e dhunshëm nga familja, miqtë, shkolla dhe/ose puna dhe mohimin e mundësisë për para ose mbështetje ekonomike.

Dhuna ekonomike - përfshin vënien në varësi ekonomike, moslejimi i punësimit, kontrolli i vazhdueshëm dhe imtësishëm i shpenzimeve, mosdhënia e mjeteve monetare, etj., ndaj një personi në marrëdhënie familjare

Dhuna fizike – përfshin, por nuk kufizohet me: çjerrjen, shtyrjen, goditjen, kapjen, rrahjen, asfiksimin, pickimin, shpimin, shkuljen e flokëve, përdredhjen e krahut, goditjen me shuplakë, gjuajtjen, djegien, therjen dhe mbytjen. Dhuna fizike mund të përfshijë përdorimin e madhësisë dhe të forcës fizike të një personi, shtrëngimet ose armët (p.sh. pistoletë, thikë ose një objekt tjetër) për të marrë dhe për të ruajtur kontrollin mbi personin tjetër. Dhuna fizike shpesh shkakton disa forma dëmtimi ose lëndimi dhe mund të shkaktojë edhe vdekje.

Dhuna seksuale – përfshin imponimin, detyrimin ose përpjekjen për të detyruar kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e personit. Abuzimi seksual përfshin, por nuk kufizohet me përdhunimin martesor, sulmet në pjesët seksuale të trupit, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimin e personit në mënyrë seksualisht poshtëruese. Abuzimi seksual kryhet nga partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes brenda kontekstit të martesës, të marrëdhënieve dashurore dhe të familjes.

Për herë të parë dhuna në familje u parashikua në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Deri atëherë të gjitha rastet e dhunës midis personave në lidhje familjare trajtoheshin si konflikte apo si veprat e tjera kundër personit të parashikuara në KP.

Qëllimi i ligjit është krijimi i një rrjeti të koordinuar institucionesh (administrative dhe gjyqësore) përgjegjëse; krijimi i strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel

qendror dhe vendor; fuqizimi i gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje dhe lëshimin e UM/UMM; sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm, falas dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit. Gjithashtu në të kanë gjetur vend dispozita për rehabilitimin e autorëve të akteve të dhunës në familje, etj.